



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

Nr _____ Prot

Vau Dejes me ____ / ____ / 2022

MIRATOHET:

KRYETARI

Mark BABANI

PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR PERIUDHEN 2023 - 2025

Plani strategjik përcakton punën që do ndërmerret nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën tre vjeçare 2023-2025. Plani strategjik përditësohet çdo vit me qëllim që të sigurohet përshtatja e tij me ndryshimet që mund të ndodhin në sistemet dhe fushat me risk që do auditohen në bashki gjatë kësaj periudhe.

Njësia e auditimit të brendshëm bazohet në një njohje të thellë të veprimtarisë dhe sistemeve të informacionit që ndihmojnë në përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe raportimit financiar në mënyrë efëcente, duke shtuar vlerë për Titullarin e njësisë publike .

1 - Qëllimi i planit strategjik

Plani Strategjik 2023-2025 i konsoliduar “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Vau Dejes” bazohet ne analizen e risqeve te programeve dhe veprimeve te identifikuarra për auditim dhe përcakton periudhen dhe frekuencen e auditimit për subjektet që programohen për tu audituar. Mbi të gjitha, funksioni kryesor i procesit të planifikimit është që të përcaktojë

fushat/subjektet e auditimit që përmbushin kriteret e mësipërme si dhe mirëqeverisjen dhe eficiencën në përdorimin e fondeve dhe pasurisë publike. Gjithashtu, planifikimi ndërlihet me çdo auditim të parashikuar, duke përfshirë objektivat e auditimit, metodën, aspektet kryesore, burimet e duhura, si dhe aktivitet mbështetëse.

Plani strategjik është bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut të hartuar njëhere në vit duke u bazuar në informacionin e drejtuesve të sektorëve dhe programeve. Gjatë hartimit të planit janë marrë parasysh angazhimet e pranuar dhe mundësia e angazhimit për të përmirësuar menaxhimin e risqeve shtimin e vlerës dhe përmirësimin e veprimtarisë së bashkë.

Spektori i Auditimit të brendshëm është konsultuar dhe ka rënë dakord me menaxhimin lidhur me problemet e kontrolleve të brendshme dhe administrimit ,duke synuar mbulimin e veprimtarive kryesore dhe me risk të lartë.

Në përfundim të procesit të auditimit jepen rekomandime ,këshilla dhe propozohen masa për të përmirësuar funksionimin dhe veprimtarinë e subjekteve të audituara.

Misioni i Nj/AB

Misioni i Auditimit të brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektive është të ndihmojë subjektet e audituara të bashkisë dhe të njëjstëve vartës të realizojnë objektivat dhe detyrat e tyre funksionale dhe operative me ekonomi,efektivitet dhe efikasitet.

Nj/AB bën vlerësime ,jep këshilla dhe rekomandime objektive:

- ✓ për përmirësimin e procesit të qeverisjes së bashkisë.
- ✓ për identifikimin ,vlerësimin dhe menaxhimin e riskut
- ✓ për funksionimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm .
- ✓ për ruajtjen vlerësimin dhe administrimin e aseteve ,
- ✓ për besueshmerinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional.

- ✓ për te siguruar titullarin e subjektit te audituar se fondet publike jane përdorur me ekonomi ,efikasitet ,efiçencë sipas planifikimit dhe qëllimit te miratuar ne buxhetin e bashkisë.
- ✓ për përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve te njësisë

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza ,rekomandime ,këshilla dhe informacion lidhur me veprimtarite dhe aktivitetin e strukturave dhe njësive që ka vlerësuar.

2 - Organizimi i Njësisë së Auditimit te Brendshëm.

Auditimi i brendshëm ne bashkinë Vau Dejës është i organizuar ne nivel sektori dhe përbëhet nga 3 punonjës që kanë varesi direkte nga Kryetari i Bashkisë ,referuar VKM nr.83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kriterëve për krijimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" pika 2;3.dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore me synimin e vetem per rritje ekonomike, angazhim dhe cilesi maksimale ne sherbimet publike te ofruara dhe sipas rregullores se bashkisë të përditësuar “Mbi Organizimin, Funkionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Vau Dejës dhe Njësive Administrative”.

Baza Ligjore mbi të cilën auditimi i brendshëm ushtron veprimtarinë e tij është si më poshtë:

- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
- VKM nr.83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kriterëve për krijimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"
- Kodi i Etikës i AB-së. Miratuar me Urdhërin e MF nr.86, datë 10.12.2015.
- VKM Nr.353 date 11.05.2016 “Për një ndryshim ne vendimin nr.83 date 03.02.2016 te Këshillit te Ministrave “Për miratimin e kriterëve për krijimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016
- Udhëzimi nr.12, datë 06.05.2012, "Për procedurat e kryerjes së aktiviteteve të auditimit të brendshëm në sektorin publik", miratuar nga Ministri i Financave.

- Urdheri nr.22 date 06.03.2017 “Per miratimin e metodologjise per vlerësimin e jashtëm te cilësisë së auditimit te brendshëm në sektorin publik.”
- Urdhëri nr.4 datë 10.01.2020 ”Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm ,miratuar me urdhërin nr.100 datë 25.10.2016”
- Udhëzimi nr.42 datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin public”.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.71 datë 23.12.2021 për miratimin e strukturës organizative te bashkisë për vitin 2022.

- **- Objektivat strategjike**

Objektivi strategjik i AB është të nxisë politikat e qeverisjes së mirë ,përmirësimin dhe forcimin e sistemeve te kontrollit te brendshëm .

Objektivat strategjike janë:

- Dhënia e sigurisë së pavarur dhe objektive ,dhënia e këshillimeve të cilat shtojnë vlerën ,përmirësojnë operacionet dhe ndihmojnë subjektet e audituara të arrijnë objektivat me efektivitet ,ekonomi dhe eficientë.
- Dhënia e sigurisë objektive ,që risqet janë identifikuar dhe vlerësohen e menaxhohen nga strukturat përgjegjëse.
- Dhënia e sigurisë së arsyeshme se sistemet e kontrollit janë vendosur ,funksionojnë me efektivitet në shkallë të përshtatshme brenda subjekteve të audituara.
- Planifikimi dhe kryerja e auditimeve të kombinuara (përputhshmërie dhe financiar)
- Kryerja e auditimeve sipas kërkesave të menaxhimit.
- Krijimi i nje koncepti te ri për auditimin e brendshëm si funksion i pavarur ,si mbështetje për menaxhimin për realizimin dhe përmbushjen me sukses te detyrave të tij.

4 - Identifikimi i subjekteve.

Në Bashkinë Vau Dejës sektori i auditimit te brendshëm do te kryej angazhime auditimi ne drejtoritë dhe sektorët e bashkisë duke i dhënë prioritet sektoreve me risk të lartë.

Në drejtorinë Drejtorinë Juridike të prokurimeve dhe Integritit, Drejtorinë Ekonomike dhe mnenaxhimit financiar, sektori Buxhetit dhe Finances ,Sektori i taksave dhe tarifave

vendore, Sektori i kontrollit dhe borxhit tatimor ,Detyrimet e prapambetura ;Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike ,Drejtorinë e Burimeve Njerëzore ;Drejtorinë e Shërbimeve Publike Bujqësisë, Emergjencave Civile dhe IT ;Drejtorinë e Pyjeve ,Mjedisit dhe Zhvillimit të Turizmit; Qendra sociale për të moshuar “BESA “, Konvikti i shkollës Profesionale “Ndre Mjeda”, Policinë bashkiake, sektorin e Mbrojtjes nga zjarri, Njësitë Administrative të bashkisë.

Auditim ,në njesinë vartëse të “Ujësjelles -Kanalizime Sha,dhe Ndërkomunale Bushat Sha.

- **- Identifikimi i sistemeve prioritare.**

NJAB realizimin e auditimeve si të subjekteve ashtu dhe të fushave të auditimit do ta kryej mbi bazën e auditimit të sistemeve, konkretisht :

- Auditimi i sistemit të programimit dhe zbatimit të buxhetit
- Auditimi i sistemit të prokurimeve publike.
- Auditim i detyrimeve të prapambetura
- Auditimi i sistemit të kontabilitetit dhe i pasqyrave financiare.
- Auditimi i sistemit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.
- Auditimi i sistemit të burimeve njerëzore.
- Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Auditim i sistemit të pranimi dhe trajtimi i të moshuarve në qendren sociale “Besa”.
- Auditim i sistemit të menaxhimit dhe trajtimit të nxënësve konviktor .
- Administrimi I sistemit të shitjeve ,mirëmbajtaj e rrjetit ,transkasionet e kryera nga Sha Ujësjellës Kanalizime .
- Auditim i rregullshmërisë në trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve në Sha Ndërkimunale Bushat.
- Auditim I planizimit dhe përballimit të sistuatave emergjente në territorin e bashkisë.
- Auditim i sistemit të studimit dhe zbatimit të strategjive efikase dhe politikave në fushën e urbanistikës.
- Auditim i sistemit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Planifikimi i Auditimit me bazë sistemi ,është bërë duke pasur parasysh anën funksionale, organizative të subjekteve, këshillat dhe opinionet e drejtuesëve të këtyre subjekteve, raportet dhe pasqyrat e subjekteve, këshillat dhe opinionet e drejtuesëve të këtyre subjekteve, raportet dhe pasqyrat financiare, subjekteve, këshillat dhe opinionet e drejtuesëve të këtyre subjekteve, raportet dhe pasqyrat financiare raportet vjetore zyrtare, raportet e mëparshme të auditit të brendshëm , rekomandime e auditit te jashtëm (K.L.Sh), me objektiv se auditimi me baze sistemi është më efektiv në veprimtarinë audituese, ku zbulohen të metat dhe mangësitë e subjekteve të audituara dhe ndërmerren veprime korigjuese

6 - Identifikimi dhe vleresimi i risqeve

Gjatë planifikimit të auditimeve për vitin 2023-2025 NJAB ka marrë në konsideratë risqet potenciale me të cilat përballen proceset gjatë auditimit, duke ju kushtuar kohë ose angazhim më shumë (kohë atyre subjekteve dhe fushave auditimi që kanë risqe të lartë.

Vlerësimi I riskut fillon me shqyrtimin e faktorëve të cilët kanë mundësinë më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur,duke ju dhënë prioritet fushave të cilat ndikohen më shumë nga ndodhja e kësaj ngjarje.

Sektorët që kanë impact më të lartë ndaj riskut dhe që ndikojnë më shumë në realizimin e objektivave të bashkisë dhe shërbimin ndaj qytetarëve janë ,sektori i taksave dhe tarifave vendore ,sektori i investimeve ,sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi,,Qendra Sociale “Besa”,Konvikti i shkollës profesionale “Ndre Mjeda,,sektori i Financës dhe buxhetit,Ujesjellës kanalizime sha,Ndërkomunale Bushat Sha,Detyrimet e prapambetura, sektori i Aseteve.

Sektor me risk të mesëm janë sektori I shërbimeve publike dhe mbrojtjes së konsumatorit, sektori i prokurimeve publike,,Sektori i burimeve njerëzore, ,sektori i asistencës ligjore dhe kontratave.Sektori i emergjencave dhe mbrojtjes civile,sektori i shërbimeve mbështetëse,Policia bashkiake ,sektori i bujqësisë,ujitjes dhe kullimit.Drejtoria e zhvillimit rural dhe turizmit.

Sektor me risk të ulët janë ato sector që kanë impact më të vogël në realizimin e objektivave të bashkisë si sektori i zyrës së integruar me një ndalesë .Njësite Administrative,sektori arsimit ,sektori i protokollit dhe arkives .

Ne tre vitet e planit strategjik janë parashikuar për tu audituar me parë institucionet dhe fushat me risk të lartë, si sektori i taksave dhe tarifave vendore, sektori i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, sektori i prokurimeve publike, sektori i investimeve, sektori i planifikimit urban, Qendra Sociale “Besa”, Konvikti i shkollës profesionale “Ndre Mjeda”, sektori i Financës dhe buxhetit, Ujesjellës kanalizime sha, Ndërkomunale Bushat Sha, Detyrimet e prapambetura,

Ne vlerësimin e riskut jemi nisur nga rezultatet e auditimeve të mëparshme për subjektet e fushat e parashikuara për auditim., ndërsa për subjektet e fushat e reja vlerësimi i riskut është bërë përgjithësisht në nivelin e lartë për shkak të njohjes së kufizuar të veprimtarisë së tyre.

Në hartimin e Planit Strategjik të AB kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

Rendësia: Njësia e AB të shpenzojë më shumë kohë për fushat e reja dhe me më rëndësi për Bashkinë.

Materialiteti : Për fushat e mëdha të të ardhurave dhe shpenzimeve të shpenzohet më shumë kohë auditimi

Ndryshimi : Kur një sistem apo fushë ka ndryshuar, risku rritet, prandaj AB të shikojë për këto ndryshime në vitin që janë bërë ndryshimet .

Risku: Burimet e AB të kushtohen fushave ku risku është më i lartë.

Pikëpamjet e menaxhimit: AB të marrë në konsideratë shqetësimet e menaxherëve.

Frekuenca : Frekuenca më e shpeshtë tek subjektet dhe fushat me risk më të lartë.

Ndikimi i jashtëm: Monitorimi i strukturës së AB.

7 - Kufizimet e Auditimit.

- ✓ Ndërgjegjësim i titullareve të subjekteve e fushave të parashikuara për auditim mbi rolin e AB si konsulencë e mbështetjeje për vlerësimin dhe përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe të veprimtarisë së tyre në tërësi.
- ✓ Mungesa e bashkëpunimit reciprok dhe përgjegjshmeria e subjekteve që auditohen . mosnjohje e detyrave dhe e të drejtave të AB.
- ✓ Mungesa e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve nga subjektet që auditohen.
- ✓ Mungesa e procesit të kontrollit të brendshëm të vendosura nga vetë subjektet që auditohen.

- ✓ Mungesa e stafit të njësisë së AB të certifikuar,dhe të kualifikuar.
- ✓ Ndryshime të shpeshta në strukturën e AB.

8 - Prioritetet per vitet 2023-2025 vazhdojnë të jenë në të njëjtat drejtime si më pare,duke rritur përgjegjshmërinë dhe integritetin profesional .

- ✓ Ngritja dhe zhvillimi profesional i audituesve .
- ✓ Monitorimi i strukturës së AB sigurimi i cilesisë së auditimit të brendshëm.
- ✓ Zhvillimi i veprimtarisë së AB në pajtueshmëri me Kartën e AB dhe dispozitat ligjore.
- ✓ Ofrimi i sigurisë se tillë që veprimtaria e AB të konsiderohet nga strukturat e larta drejtuese si shtim vlere dhe përmiresim i aktiviteteve dhe veprimtarisë së subjekteve .

Bashkëlidhur me planin strategjik janë anekset si më poshte:

Anekset e planit Strategjik:

- ✓ Pasqyra 1, ”Vlerësimi i nivelit te riskut për subjektet për vitet 2023-2025” sipas përcaktimeve te Drejtorise se Harmonizimit te AB të Ministrisë se Financave.
- ✓ Pasqyra 2, “Plani strategjik i subjekteve te synuara për tu audituar ne vitet 2023-2025” sipas përcaktimeve te Drejtorise se Harmonizimit te AB Ministrise se Financave.

P/sek.Auditimit

Ardiana Ndoci



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

**MIRATOHET:
KRYETARI**

Mark BABANI

**PLANI VJETOR I AUDITIMIT
Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vau Dejës”**

NJAB për vitin 2023 harton planin vjetor të auditimit mbështetur në ligjin 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” Kreu II “Misioni, roli dhe parimet e auditit të brendshëm publik”, VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJAB-ve në sektorin publik”, Urdhërit të Ministrisë Financave nr.100 date 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” të ndryshuar, shkresës së NJQHAB Nr.16986 Prot, datë 26.09.2022, Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2023 është hartuar sipas kësaj strukture :

- Zhvillimet aktuale të NJAB
- Prioritetet e auditimit për vitin 2023
- Objektivat kryesore
- Programimi i llojit të angazhimeve

- Planifikimi i kostos
- Planifikimi i burimeve
- Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim
- Sigurimi i brendshëm i cilësisë

- **Zhvillimet aktuale te Nj.AB**

Njësia e Auditimit të brendshëm në bashki është e organizuar në bazë Sektorit mbështetur në kriteret ligjore.

Numri i audituesve është 3 (tre) nga të cilët 1 (një) Përgj Sektorit e 2 (dy) auditues.

Sektorit i auditimit të brendshëm ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vetvendore”; Ligjit Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe akteve të tjera ligjore e nenligjore me synimin e vetëm për rritje ekonomike, angazhim dhe cilësi maksimale në shërbimet publike të ofruara. Sektorit i Auditimit të brendshëm të bashkisë Vau Dejës për vitin 202 ka planifikuar 14 auditime dhe janë realizuar 10 auditime deri në këtë moment.

- **Prioritetet e auditimit për vitin 2023.**

NJAB për realizimin e Programit Strategjik e Vjetor ka si prioritet të kontribuojë të Institucioni i Bashkisë dhe Ndërmarrjet e Varësisë për funksionimin sa më të mirë të sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhe menaxhimit financiar .

- Të insistojë ndaj subjekteve për zbatimin e dispozitave ligjore, rregulloreve e procedurave në veprimtarinë operative, me synim për të qenë të përgjegjshëm ndaj publikut si dhe për të siguruar kryerjen e transaksioneve financiare me efikasitet dhe efikasitet.
- Të japë siguri objektive subjekteve audituese mbi saktësinë e besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës të përgatitura nga ana e strukturave të menaxhimit.
- Të ndihmojë menaxhimin e subjekteve që do të auditohen për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të vendosura, duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet e subjekteve.
- Të minimizojë dhe eliminojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim të aseteve të subjekteve audituese .
- Të ndihmojë punonjësit për përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatimin e kontroleve të vendosura , për funksionimin sa më të mirë të sistemeve të kontrollit të

brendshëm.NJAB për realizimin e Programit Strategjik dhe Vjetor të auditimit të brendshëm do të mbështetet në standartet dhe metodologjine e auditimit të brendshëm publik dhe parimet e auditimit . Veprimtaria e auditit të brendshëm do të jetë e pavarur dhe objektive në dhënien e mendimeve dhe të gjykimeve gjatë kryerjes së auditimit.

NJAB për realizimin me sukses të këtij programi do synojë në rritjen e kompetencës dhe profesionalizmit të audituesve në veprimtarinë e auditimit si dhe do jetë gjithmonë e gatshme për të dhënë shërbime këshillimi subjekteve që do të auditohen sipas kërkesës nga ana e tyre me qëllim shtimin e vlerës, përmirësimin e qeverisjes, përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të rriskut

▪ **Objektivat kryesore per vitin 2023.**

Auditimi i brendshëm ne ushtrimin e veprimtarisë se tij të pavarur dhe objektive synon te ndihmojë subjektet e audituara te bashkisë Vau Dejës te përmbushin objektivat e tyre. Ai bën vlerësime ,jep këshilla dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së bashkisë.

-për mirë funksionimin dhe mjaftueshmërinë e sistemeve ,per përputhjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore.

-për funksionimin e elementeve te kontrollit te brendshem

-për të siguruar titullarin e bashkisë se fondet janë përdorur me ekonomi,efikasitet dhe efikasitet ,sipas planifikimit dhe qëllimit të miratimit në buxhetin e bashkisë .

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza ,rekomandime ,këshilla dhe informacion lidhur me veprimtaritë dhe fushat që ka vlerësuar.Duke asistuar te gjitha nivelet e menaxhimit ne kryerjen me efektivitet te përgjegjesive te tyre i jep menaxhimit te lartë vlerësime të hartimit të dokumentacionit ,të transaksioneve dhe arkëtimeve si dhe veprimeve të tjera ,këshillime te pavarura konfidenciale.

Qëllimi i funksionit te auditimit të brendshëm është të nxisë politikat e qeverisjes së mirë,përmirësimin dhe forcimin e sistemeve te kontrollit te brendshëm në gjitha subjektet e audituara .

AB ka për qëllim :

- ✓ Dhënien e sigurisë objektive dhe të pavarur që sistemet e kontrollit janë vendosur ,funksionojnë me efektivitet brenda subjekteve te audituara .
- ✓ Dhënien e këshillimeve te cilat shtojnë vlerën ,përmirësojnë veprimet dhe ndihmojnë subjektet e audituara te arrijnë objektivat e vendosura.
- ✓ Planifikimin ,kryerjen e auditimeve te kombinuara ,(përputhshërie dhe financiare)

- ✓ Kryerjen e auditimeve sipas kërkesave të menaxhimit.
- ✓ Krijimin e një koncepti të ri për auditimin e brendshëm si funksion i pavarur ,si mbështetje për menaxhimin për realizimin me sukses të detyrave të tij.

▪ **Programimi i llojit të angazhimeve.**

Për vitin 2023 janë parashikuar 12 fusha auditimi prej të cilave 10 fusha auditimi janë parashikuar për bashkinë dhe 2 për Ndërkomunale Bushat Sha ,dhe Ujësjellës Kanalizime Sha ,ndërmarrje vartësie.Nga këto 10 auditime janë parashikuar 9 auditim përputhshmërie ,dhe 3 auditime të kombinuara .

▪ **Planifikimi i kostos për vitin 2022.**

Në përcaktimin e kostove të auditimit , konkretisht në planifikimin e kohës së punës ,krahas kohës së nevojshme për punën audituese janë marrë parasysh edhe faktorët:

- ✓ Koha për mbikëqyrjen - e gjithë puna audituese është subjekt rishikimi nga titullari për të siguruar cilësinë e punës.
- ✓ Koha për trajnim –është planifikuar një kohë e caktuar për trajnim për ngritjen e nivelit profesional të AB.
- ✓ Koha për ndjekjen e rekomandimeve –është kohë për të verifikuar nëse menaxhimi ka vepruar në kohë për zbatimin e rekomandimeve.
- ✓ Koha për menaxhim dhe administrim - e cila parashikon kryerjen e detyrave të veçanta të caktuara nga menaxhimi .

Për vitin 2023 është përlogaritur kostoja për 3 punonjës për paga ,sigurime shoqërore ,udhëtime e dieta,dhe të tjera,në masën 200 ditë /personi me kosto 1.122 ,000 lekë për secilin punonjës e trajtuar më hollësisht në pasqyrën 5 bashkëlidhur.

▪ **Planifikimi i burimeve për vitin 2023.**

Një nga fazat e përgatitjes së planit strategjik është edhe përlogaritja e burimeve të auditimit të brendshëm të përshtatshme të mjaftueshme dhe të shpërndara në mënyrë efektive për të përmbushur planin e miratuar.Koha që planifikohet për kryerjen e veprimtarisë së auditimit dhe realizimin e objektivave të caktuara çdo vit kufizohet nga burimet në dispozicion të NjAB-së.

Sisteme me risk të lartë kërkojnë më shumë kohë në dispozicion se ato me risk të mesëm dhe të ulët. Koha maksimale e vlefshme për realizimin e programit vjetor të auditimit është 780 ditë/njëvjeçar, nga të cilat pushime vjetore 60 ditë/4 javë personi, festa zyrtare 11 ditë/personi, pushime për arsye shëndetësore 5 ditë/personi, angazhime në trajnime 10 ditë/personi, angazhime në mbledhje dhe takime 1 ditë/çdo muaj dhe rezerva të planifikuara (të papritura) 10 ditë/personi . Totali i burimeve të vlefshme për realizimin e programit të auditimit është 600 ditë ose 200 ditë për person .

- **Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim.**

Gjatë planifikimit të nevojave për trajnim kemi mbajtur parasysh se nevojave për kualifikim është e percaktuar si kërkesë e ligjit “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” ku audituesit në detyrë kanë të domosdoshme pjesëmarrjen në trajnimet përditësuese në nivelin e 40 (dyzet) orëve në vit. Kemi percaktuar sipas gjykimit tonë edhe disa nga drejtimet kryesore ku kemi nevojë të fokusokemi në këto trajnime, me qëllim përditësimin e njohurive dhe shkëmbimin e eksperiencës me audituesit e rretheve të tjera dhe me trajnerët.

Për auditueset e pa çertifikuara kemi planifikuar nevojat e trajnimit të tyre dhe çertifikimit brenda këtyre dy viteve. Ndryshimet në Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Ligjin për Inspektimin Financiar dhe Ligjin për Financat Vendore, në zbatim të kuadrit ligjor në fushën e financave publike, synojnë një strukturim të sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Auditimit të Brendshëm në përputhje të plotë me Standartet Ndërkombëtare të pranuar. Si pjesë e rëndësishme e sistemit të KBFP-së është Auditimi i Brendshëm. Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm kryhet në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që të vlerësojë dhe përmirësojë strukturat e menaxhimit efektiv të riskut dhe të kontrollit të transaksioneve financiare dhe në këtë kuadër bëhet hartimi i një Planit Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm. Plani vjetor bazohet mbi një rishikim të përgjithshëm të sistemit të auditimit si dhe të sistemeve e proceseve, që në kuadrin e reformes administrative janë ndërmarrë. Vlerësimi i nevojave të auditimit rishikohet çdo vit në kohën kur hartohet plani vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke u siguruar, që janë të përfshira në planin e konsoliduar të gjitha veprimtaritë e reja dhe/ose ndryshimet e tjera të programeve.

Analiza e nevojave për trajnim të sektorit të auditimit të brendshëm sipas termave ju dërgohet në pasqyren 4 bashkëlidhur materialit.

- **Sigurimi i brendshëm i cilësisë**

Sigurimi i brendshëm i cilësisë do të kryhet nga vetë njësia e auditimit të brendshëm nëpërmjet 3 komponentëve .

- Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
- Vetë-vlerësim periodik nga njësia e auditimit të brendshëm ose një vlerësim të lehtësuar nga të tjerë në njësinë publike me njohuri të mjaftueshme të praktikave të auditimit të brendshëm dhe
- sondazhi i një subjekti të audituar

Monitorimi i vazhdueshëm do të jetë i përcaktuar në përshkrimet e punës dhe veprimet operative (politikat, procedurat dhe praktikat) që do të rregullojnë veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm. Audituesi më me përvojë në grup ose në njësinë e auditimit të brendshëm është përgjegjës për procesin e monitorimit të vazhdueshëm

Vetëvlerësimi periodik kryhet për të vlerësuar përputhshmërinë me parimet bazë të Strukturës Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale (IPPF) të auditimit të brendshëm, si: përkufizimi i auditimit të brendshëm, Kodi i Etikës, standardet ndërkombëtare dhe me kërkesat specifike të manualit të auditimit të brendshëm. Audituesi brenda njësisë së auditimit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme të praktikave të mira të auditimit do të kryejë vetëvlerësimin periodik. Subjektet e audituara, mund të përdorin pyetësozin për reagimin ndaj misionit të auditimit (Feedback-un) për të ndëshkuar grupin e auditimit të brendshëm për raportin e auditimit jo të kënaqshëm apo për të shprehur mendimet pozitive për ta . Studimi i subjektit të audituar, në fund të angazhimit të auditimit të brendshëm është një mjet i mirë që mund të përdoret nga njësia e auditimit të brendshëm për të marrë informacion të vlefshëm.

Bashkëlidhur me planin vjetor janë pasqyrat:

- **Pasqyra 3** “Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2023” sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të AB të Ministrisë së Financave .
- **Pasqyra 4** ”Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2023” sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të AB të Ministrisë së Financave .
- **Pasqyra 5** “Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarje të burimeve të NJAB për vitin 2023”

P/Sektorit të Auditimit

Ardiana Ndoci

